



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 140/ Prot.
17

Tiranë, më 04.022020.

V E N D I M

Nr. 10 dt. 04.022020

**MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE ANALITIKE, DHE
KLASIFIKIMIT TË PAGËS, PËR VITIN 2020.**

Në zbatim të pikës 1/ç, të nenit 49, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në VKM nr. 123 datë 17.02.2010 “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në Urdhërin e MASR me Nr.495, datë 11.10.2019 “Për hapjen e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit” në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, VKM Nr.268, datë 29.03.2017 “Për disa ndryshime në VKM Nr.748, datë 11.06.2009 i ndryshuar “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nënpunësve civilë/nënpunësve, zëvendësministrit dhe nënpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, VKM Nr.329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, në VKM Nr.202, dt.15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.717, datë 23.06.2009 të KM, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore” të ndryshuar, Vendimin e Senatit nr. 7 datë 28.01.2020, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 04.02.2020

V E N D O S I :

1. Miratimin e Strukturës Organizative dhe Analitike dhe kategorinë e pagës, për vitin 2020 për stafin e Universitetit të Sporteve të Tiranës sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Numri efektiv i Universitetit të Sporteve të Tiranës 146 persona
3. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FSHL 6 persona

4. Numri i punonjesve me kontratë të përkohshme staf akademik FVFR 10 persona
5. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf administrativ dhe të shërbimeve
4 persona
6. Efektet financiare mbulohen nga fillimi deri në fund të vitit 2020 nga granditë e ardhura nga MASR dhe të ardhurat e Universitetit.
7. Ngarkohen Rektori, Njësitë kryesore, Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe Arkivës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

HYSEN DOMI

